

**GJYKATA E QARKUT GJILAN**  
AC. nr. 351/2009

**GJYKATA E QARKUT GJILAN**, përmes trupit gjykues të përberë nga Gjyqtarja e EULEX-it Johanna Schokkenbroek, kryetare e trupit, Gjyqtari i EULEX-it Klaus Jung dhe Gjyqtari Hasan Sadiku, si anëtarë, me asistencë të zyrtares ndërkombëtare ligjore Alice Pisapia dhe përkthyesit në gjuhën shqipe Daut Latifaj, në çështjen gjyqësore të paditëses Agjencia Kosovare e Privatizimit (adresa: Rr. Llis Konushevcit nr. 8 Pristine, me përfaqësuesin ligjor: Naser Krasniqi) kundër të paditurit Kuvendi Komunal-Komisioni Regullativ për Prokurim Publik Viti (adresa: Komuna e Vitisë 61000 Kosove, me përfaqësuesin ligjor: Ibrahim Ramadani) pas shqyrtimit lidhur me ankesën e paditëses Agjencia Kosovare e Privatizimit të ushtruar kundër aktvendimit C.nr. 328/2009 për jokompetencë të Gjykatës Komunale në Viti, të datës 7 tetor 2009, në seancën jo publike të mbajtur më dt.16.04.2010 mori këtë

**AKTVENDIM**

Aprovohet ankesa e paditëses Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe aktvendimi i Gjykatës Komunale të Vitisë, C.nr. 328/2009, të datës 7 tetor 2009 **PRISHET** dhe i dërgohet Gjykatës Komunale të Vitisë në rishqyrtim.

**ARSYETIMI**

*Vlerësim i bazuar në fakte*

Me 2 tetor 2009, Paditësja Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) parashtron padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë me kërkesë për masën e përkohshme në Gjykatën Komunale të Vitisë. I padituri është Kuvendi Komunal-Komisioni Regullativ për Prokurim Publik Viti (KKV).

Përmes padisë së saj paditësja ka kërkuar të përcaktohet si pronare ligjore dhe faktike e ngastrës kadastrale nr. 709-3 të evidentuar në emër të N.Sh. Banja e Kllokotit në Kllokot-Viti, Zona Kadastrale Kllokot dhe të ndërpriten të gjitha veprimet dhe të anulohen aktet e paligjshme të palës së paditur.

Me aktvendimin e saj C. nr. 328/09, të datës 07 tetor 2009 Gjykata Komunale e Vitisë u shpall jokompetente për të vendosur rreth padisë të parashtruar nga AKP-ja në lidhje me

masës së përkohshme. Vendimi është bazuar në Nenet 4 dhe 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13 të datës 13 qershor 2002.

AKP-ja paraqiti ankese kundër aktvendimit të datës 20 tetor 2009 në Gjykatën e Qarkut të Gjilanit duke konstatuar se Gjykata kompetente për atë padi është Gjykata Komunale e Vitisë. Sipas ankesës, Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 (mbi Themelimin e Odes së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës) Neni 4.1, Oda e Veçante e Gjykatës Supreme të Kosovës nuk ka kompetencë sepse kjo Rregullore e zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2002/13 të datës 13 qershor 2002.

Me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 23 shkurt 2010, lënda e tanishme i është caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

Me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 15 mars 2010, Gjyqtarja e EULEX-it Johanna Schokkenbroek është caktuar si kryetare e trupit gjykues dhe me vendimin e Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, të datës 08 prill 2010, gjyqtari i EULEX-it Klaus Jung është caktuar për anëtar të trupit gjykues. Gjyqtari i tretë në trupin gjykues, Hasan Sadiku, është emëruar nga Kryetari-kryes detyre i Gjykatës së Qarkut në Gjilan.

### **Arsyetimi ligjor**

Neni 41 i Ligjit të aplikueshëm për Procedure Kontestimore, Ligji nr. 03/L-006 (LPK) konstaton:

*41.1 Për gjykim në kontestet lidhur me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak pengim posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo lokaleve të punës, është ekskluzivisht kompetent gjykata në territorin e të cilës ndodhet paluajtshmëria.*

Neni 4.1. i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 (mbi Themelimin e Odes së Vecante të Gjykatës Supreme të Kosovës) konstaton:

*4.1 "4.1 Panelet gjyqësore të Dhomës së Posaçme kanë juridiksion parësor për kërkesat dhe kundërkërkesat që lidhen me:*

.....  
.....

*(c) Paditë, duke përfshirë paditë e kreditorëve ose paditë pronësore, të bëra kundër një ndërmarrjeje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin*

*administrues të Agjencisë, kur këto padi kanë lindur gjatë, ose para se ndërmarrja apo korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;*

Sipas Nenit 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ajo zëvendëson çdo dispozitë në Ligjin e Aplikueshëm e cila nuk është në pajtueshmëri me të.

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 jurisdikcioni i Odes së Veçantë është i kufizuar në paditë e parashtruara kundër AKM-se dhe ndërmarrjeve të administruara nga AKM-ja. Pra, Oda e Veçantë nuk ka kompetencë për paditë e parashtruara kundër Komunave. Prandaj, çështja e kompetencës në raste të tilla është e rregulluar me LPK-ne.

Sipas Nenit 41 të LPK-se gjykata kompetente për këto raste është Gjykata Komunale e Vitisë.

Ky vendim është në përputhje me jurisprudencën e Odes së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës (SCC-09-0023) ku është vendosur që jurisdikcioni i Odes së Veçantë është i kufizuar në paditë e kundër AKM-se dhe ndërmarrjeve të administruara nga AKM-ja.

Me që nuk është marrë vendimi lidhur me çështjen e padisë lënda duhet t'i dërgohet Gjykatës Komunale të Vitisë në rishqyrtim.

Prandaj, është vendosur si në diapozitivin e këtij aktvendimi.

#### *Shpenzimet e procedurës gjyqësore*

Me që nuk ka pas kërkesë për kompensim të shpenzimeve të procedurës gjyqësore atëherë nuk do të jepet kompensimi.

### **Gjykata e Qarkut e Gjilanit AC. nr. 351/2009**

Përpiluar në anglisht,  
si gjuhë zyrtare.



Qëtarja e trupit gjykues  
Johanna Schokkenbroek

#### *Udhëzimit juridik*

Sipas Nenit 228.1 të LPK kundër këtij vendimi nuk lejohet revizioni